



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** me datë **10.12.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Marrjen në pyetje të personit të arrestuar **Arben Tusha** me qëllim verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit. Lënien në fuqi të masës së sigurimit personal, ndaj shtesit Arben Tusha, caktuar me vendimin nr.73, datë 11.10.2022 të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Erjon Bani, Irena Gjoka dhe Flojera Davidhi, bazuar në nenet 112, 248 dhe 260 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. 153, datë **11.12.2024**, vendosi:

1. Vazhdimin e masës së sigurimit “**Arrest në burg**” parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Arben Tusha** me vendimin nr. 73, datë 11.10.2022 të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*” parashikuar nga neni 259/2 i Kodit Penal.
2. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në bashkëpunim me policinë gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 11.12.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar